



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.178

22 dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.1108, datë 28.10.2009	Për përcaktimin e numrit të punonjësve mësimorë, me kontratë të përkohshme, për periudhën 14 shtator–31 dhjetor 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës	7861
Vendim i KM nr.1109, datë 13.11.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	7865
Vendim i KM nr.1113, datë 13.11.2009	Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifën e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010.....	7865
Vendim i KM nr.1114, datë 13.11.2009	Për dhënien e bursave nxënësve të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2009-2010	7873
Vendim i KM nr.1115, datë 13.11.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në fakultetin e ekonomisë dhe administrimit të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2009-2010, në këtë program studimi	7874
Vendim i KM nr.1116, datë 13.11.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në “Arkitekturë–Urbanistikë”, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2009-2010, në këtë program studimi	7875
Vendim i KM nr.1123, datë 13.11.2009	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.1035, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e tarifës së licencimit të subjekteve, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në fushën e punimeve të ndërtimit dhe transportit”	7875

Vendim i KM nr.1124, datë 13.11.2009	Për lejimin e shtyrjes së afatit të procedurave të prokurimit për Gjykatën e Lartë, me objekte “Blerje detektor kontrolli” dhe “Botimet e vendimeve të Gjykatës së Lartë” 7876
Vendim i KM nr.1125, datë 13.11.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.954, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, strukturën, funksionimin e qendrës ndërinstitucionale operationale detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det” 7877
Vendim i KM nr.1126, datë 13.11.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2009, në ministritë dhe institucionet qendrore” të ndryshuar 7878
Vendim i KM nr.1127, datë 13.11.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pezë të qarkut të Tiranës 7879
Vendim i KM nr.1128, datë 13.11.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dajç të qarkut të Lezhës..... 7880
Vendim i KM nr.1129, datë 18.11.2009	Për miratimin e stemës së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar..... 7881
Vendim i KM nr.1130, datë 18.11.2009	Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, 2010-2012 7882
Vendim i KM nr.1131, datë 13.11.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.825, datë 28.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, të ndryshuar..... 7883
Vendim i KM nr.1132, datë 13.11.2009	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës 7883
Vendim i KM nr.1133, datë 18.11.2009	Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të shoqërive “Advisor C. Energy”, sh.p.k., “Polistamp System”, SRL, e “Energia e Territorio”,SRL, për ndërtimin e hidrocentraleve “Bjeshkë”, “Veleshica 1”, “Veleshica 2”, “Veleshica 3”, “Veleshica 4”, “Veleshica 5”, “Veleshica 6” dhe “Sllovë” 7884
Vendim i KM nr.1135, datë 18.11.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës së Korpusit, në bashkinë e Shkodrës. 7884
Vendim i KM nr.1136, datë 18.11.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës së tatimeve, në bashkinë e Peqinit .. 7886

Vendim i KM nr.1137, datë 18.11.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.933, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë, Shtetet e bashkuara të Amerikës, Gjermani, Francë dhe EUROPOL”, të ndryshuar.	7887
Vendim i KM nr.1177, datë 25.11.2009	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në çështjet doganore	7887
Vendim i KM nr.1180, datë 3.12.2009	Për përcaktimin e autoritetit të autorizuar për dhënien e licencës për “Lotari kombëtare” dhe të licencave për “Kazino”	7896
Vendim i KM nr.1181, datë 3.12.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.366, datë 15.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë”	7897
Vendim i KM nr.1183, datë 3.12.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në Institutin e Studimeve Europiane, në Universitetin e Tiranës, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe	7897
Vendim i KM nr.1184, datë 3.12.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, në Universitetin e Tiranës, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifave të shkollimit në këto programe	7898
Vendim i KM nr.1185, datë 3.12.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program	7899
Vendim i KM nr.1190, datë 13.11.2009	Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit	7900

VENDIM
Nr.1108, datë 28.10.2009

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE MËSIMORË, ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIUDHËN 14 SHTATOR – 31 DHJETOR 2009, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve mësimorë me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2009-2010, për periudhën 14 shtator-31 dhjetor 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të jetë 2 243 (dy mijë e dyqind e dyzet e tre) veta.

2. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, sipas DAR/ZA-ve, dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve janë përcaktuar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRI I PUNONJËSVE MËSIMORË ME KONTRATË TË PËRKOHSHME DUKE FILLUAR NGA DATA 15 SHTATOR-31 DHJETOR 2009

Nr.	Emërtimi	Punonjës me kontratë të përkohshme 15 shtator-31 dhjetor 2009		
		Deri 30 qershor	15 shtator-31 dhjetor	
I	Berat	106	65	
a	Arsimi bazë 0,42	96	65	
b	Arsimi i mesëm i përgjithshëm 0,43	4	0	
c	Arsimi i mesëm profes. 0,44	5	0	
d	Ars.Mes.Prof.Komb 0,44	1	0	
I	Skrapar	31	20	
a	Arsimi bazë 0,42	25	17	
b	Arsimi i mesëm i përgjithshëm 0,43	3	2	
c	Arsimi i mesëm profes. 0,44	3	1	
I	Kuçovë	14	0	
a	Arsimi bazë 0,42	9	0	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	2	0	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	3	0	
I	Durrës	180	180	
a	Arsimi bazë 0,42	173	179	
b	Arsimi i mesëm 0,43	1	1	
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	6		

	Sh. "B. Çela"	2		
	Sh. "B. Qerazhi"	4		
I	Krujë	54	44	
a	Arsimi Bazë 0,42	53	44	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	1	0	
I	Dibër	83	64	
a	Arsimi bazë 0,42	69	51	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	10	8	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	4	5	
I	Bulqizë	26	26	
a	Arsimi bazë 0,42	21	21	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	5	5	
I	Mat	107	81	
a	Arsimi bazë 0,42	95	76	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	11		
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	1	5	
I	Elbasan	209	180	
a	Arsimi bazë 0,42	179	146	
b	Arsimi i Mesëm 0,43	16	18	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	10	10	
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	4	6	
	Sh. "Luigj Gurakuqi"	1	0	
	Sh. "Ali Myftiu"	3	6	
I	Gramsh	33	30	
a	Arsimi bazë 0,42	28	25	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	5	5	
I	Librazhd	60	35	
a	Arsimi bazë 0,42	60	32	
a	Arsimi i Mesëm 0,43	0	3	
I	Peqin	51	39	
a	Arsimi bazë 0,42	50	38	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	1	1	
I	Fier	197	150	
a	Arsimi bazë 0,42	187	140	
b	Arsimi i Mesëm 0,43	5	5	
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	5	5	
	Sh. Artistike "Jakov Xoxa"	5	5	
I	Mallaksatër	31	26	
a	Arsimi bazë 0,42	31	26	
I	Lushnjë	77	70	
a	Arsimi bazë 0,42	62	49	
b	Arsimi i Mesëm 0,43	10	19	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	5	2	
I	Gjirokastrë	34	2	
a	Arsimi bazë 0,42	27	2	
b	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	7	0	
I	Përmet	17	0	
a	Arsimi bazë 0,42	12	0	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	5	0	
I	Tepelenë	37	15	

a	Arsimi bazë 0,42	36	15
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	1	0
I	Korçë	81	55
a	Arsimi bazë 0,42	75	51
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	6	4
I	Kolonjë	6	7
a	Arsimi bazë 0,42	5	7
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	1	0
I	Devoll	12	2
a	Arsimi bazë 0,42	10	2
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	2	0
I	Pogradec	47	40
a	Arsimi bazë 0,42	46	39
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	1	1
I	Kukës	64	60
a	Arsimi bazë 0,42	60	56
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	4	4
I	Has	57	57
a	Arsimi bazë 0,42	55	52
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	2	5
I	Tropojë	54	66
a	Arsimi bazë 0,42	47	58
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	7	8
I	Lezhë	86	86
a	Arsimi bazë 0,42	71	80
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	15	4
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	0	2
I	Laç	63	50
a	Arsimi bazë 0,42	58	49
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	5	1
I	Mirditë	66	48
a	Arsimi bazë 0,42	66	48
I	Shkodër	241	69
a	Arsimi bazë 0,42	199	63
b	Arsimi i Mesëm 0,43	23	3
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	7	3
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	12	0
	Sh. Industriale “Arben Broci”	4	0
	Sh.Pyjore “Kol Margjini”	4	0
	Sh. Artistike “Preng Jakova”	4	0
I	Pukë	13	0
a	Arsimi bazë 0,42	10	0
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	3	0
I	Malësi e Madhe	39	32
a	Arsimi bazë 0,42	37	27
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	2	5
I	Kavajë	31	22
a	Arsimi bazë 0,42	26	19
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	5	0
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	0	3

	Sh. Agrobiznes Golem	0	3	
I	Bashkia Tiranë	557	343	
a	Arsimi bazë 0,42	263	223	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	167	70	
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	127	50	
1	Shkolla e Mesme “Jordan Misja”	67	30	
2	Shkolla e Mesme Hoteleri Turizëm	7	3	
3	Shkolla e Mesme Koreografike	8	3	
4	Shkolla e Mesme “L. Boriçi”	2	1	
5	Shkolla e Mesme e Gjuhëve të Huaja	13	4	
6	Shkolla e Mesme Ekonomike	13	4	
7	Shkolla e Mesme e Ndërtimit	8	2	
8	Shkolla e Mesme Teknike	9	3	
I	Tirana Rreth	134	147	
a	Arsimi bazë 0,42	105	105	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	29	38	
c	Arsimi i Mesëm Profesional	0	4	
I	Vlorë	87	72	
a	Arsimi bazë	73	63	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	10	6	
c	Arsimi i Mesëm Profesional	2	1	
d	Ars. Mes.Prof. Komb.	2	2	
	Sh. Industriale “Pavarësia”	2	2	
I	Sarandë	56	50	
a	Arsimi bazë	52	44	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	0	4	
c	Arsimi i Mesëm Profesional	4	2	
I	Delvinë	20	10	
a	Arsimi bazë	19	10	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	1	0	
A.	Arsimi Parauniversitar	3061	2243	
1	Arsimi bazë 0,42	2490	1922	
2	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	357	216	
3	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	57	39	
4	Ars. Mes.Prof. Komb.	157	66	

VENDIM
Nr.1109, datë 13.11.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE
ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 8 nëntor 2009, të një autokolonave ushtarake italiane, të përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 15 (pesëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit- Qafë-Thanë në datën 10 nëntor 2009, të një autokolonave ushtarake italiane, të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 33 (tridhjetë e tre) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi, është porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1113, datë 13.11.2009

PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË
DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË
PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2009-2010, të jenë 6145, të cilat të ndahen, si më poshtë vijon:

a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme	5905;
b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë	40;
c) Kuotat për transferim studimesh	100;
ç) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe për shtetas të tjerë të huaj	100.

2. Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 1 të këtij vendimi, të shpërndahen sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kuota e çdo programi studimi në raportin 2:1, përkatësisht, për pranimet e reja, për programe studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe për pranimet e reja, për programe të dyta studimi.

3. Kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e tjerë të huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe të kërkesave individuale të këtyre shtetasve.

5. Çdo shtetas shqiptar, i cili ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron dëftesë pjekurie apo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, ekuivalente me të, ka të drejtë të kandidojë për në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë.

6. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

7. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin studimet, me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, brenda kuotës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, e fitojnë këtë të drejtë, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë e të bëra publike paraprakisht.

8. Tarifat e shkollimit (për 180 kredite) dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Tarifat e shkollimit (për 180 kredite) dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programe të dyta studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Përfshihen nga tarifa e shkollimit kandidatët, të cilët fitojnë të drejtën për të studiuar në një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, si program i parë studimi, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010, që u përkasin këtyre shtresave shoqërore, si të verbërit, të shurdhët, invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë, kryefamiljaret (gratë) me fëmijë, kandidatët, që vijnë nga familje, të cilat trajtohen me ndihmë sociale, si dhe fëmijët, që gëzojnë statusin ligjor të jetimit.

11. Këtë të drejtë e kanë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave shoqërore.

12. Studentët e paguajnë tarifën e shkollimit të ndarë në këste vjetore, në përputhje me kreditet e lëndëve, që do të frekuentojnë në çdo vit akademik. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit për një lëndë sa herë e frekuenton atë.

13. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin pasardhës.

14. Shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e tjerë të huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë përcaktuar mënyra të tjera për tarifat.

15. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KUOTA E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010

Tabela nr.1

Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë në vitin akademik 2009-2010

Nr.	Programi i studimit	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	Σ
1	Histori	250					60	310
2	Gjeografi	250					60	310
3	Histori-gjeografi			100	100			200
4	Gjuhë-letërsi	250		100	100	100	60	610
5	Gazetari							
6	Edukatë qytetare			80				80
7	Anglisht							
8	Frëngjisht							
9	Italisht							
10	Gjuhë spanjolle							
11	Rusisht							
12	Gjermanisht							
13	Gjuhë letërsi greke							
14	Gjuhë turke							
15	Cikli i ulët			200	100	75	60	435
16	Cikli i ulët parashkollor			100	100	75	60	335
17	Fizkulturë							
18	Matematikë						60	60
19	Fizikë						60	60
20	Inxh.matematike dhe informatike							
21	Matematikë-fizikë			80	100			180
22	Biologji-kimi			90	100		60	250
23	Biologji	100						100
24	Kimi							
25	Kimi ushqimore							
26	Kimi industriale							
27	Matematike-informatike							
28	Informatikë							
29	Teknologji informacioni							
30	Punë Sociale	100		100				200

31	Filozofi							
32	Filozofi-sociologji			100				100
33	Sociologji							
34	Pedagogji e specializuar							
35	Psikologji	100						100
36	Shkencat politike							
37	Drejtësi	200					60	260
38	Shëndeti publik							
39	Mjekësi							
40	Stomatologji							
41	Farmacë							
42	Infermieri e përgjithshme							
43	Mami							
44	Teknik imazherie							
45	Teknik laborator							
46	Fizioterapi							
47	Infermieri (Kukës)							
48	Mami (Infermieri)							
49	Tek. i lartë laborator							
50	Fizioterapi							
51	Logopedi							
52	Imazheri							
53	Administrim publik				100			100
54	Administrim-biznes	130		100		75	60	365
55	Ekonomiks							
56	Ekonomia dhe e drejta							
57	Financë-kontabilitet	130		100	100	90	60	480
58	Info ekonomike							
59	Administrim-biznes (turizëm)Sarandë							
60	Administrim-biznes (Kukës)							
61	Turizëm				100	75	60	235
62	Marketing					75		75
63	Turizëm (Pogradec)					60		60
64	Inxh.navigacioni							
65	Inxh.metalurgji materiale							
66	Inxh.tekstile dhe mode							
67	Inxhinieri elektrike							
68	Inxh.elektronike							
69	Inxh. informatike							
70	Inxh. telekomunikacioni							
71	Inxh.mekatronike							
72	Inxhinieri ndërtimi							
73	Inxhinier hidroteknik							
74	Arkitekturë							
75	Inxh.matematike							
76	Inxh.fizike							
77	Inxhinier gjeodet							
78	Inxh.mjedisi							
79	Inxh. në shkencat e tokës							

80	Inxh.gjeoinformatike							
81	Inxh.i gjeoburimeve							
82	Menaxhim agrobiznesi		100			75		175
83	Ekonomi dhe P. Agrare		100					100
84	Financë-kontabilitet		100					100
85	Mbrojtje bimësh		50					50
86	Hortikulturë		50			75		125
87	Prodhim bimor		50					50
88	Zootekni dhe biznes blegtoral		50					50
89	Akuakulturë dhe menaxh. peshkimi		50					50
90	Agromjedis dhe ekologji		50					50
91	Tek. agroushqimore		50					50
92	Vreshtari-enologji		50					50
93	Inxhinier pyjesh		60					60
94	Inxhinier përpunim druri		60					60
95	Mjekësi veterinare							
96	Agromekanizim		30					30
97	Shkenca të administrimit							
98	Menaxhim turizmi							
	GJITHSEJ	1510	850	1150	900	775	720	5905

Nr.	Programi i studimit	UPT
1	Inxh.Mek/Inxh.Logjistikë Prodhimi	40

Tabela nr.2. Tarifat e shkollimit për program të parë studimi me kohë të pjesshme

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për prog. të parë	Tarifë totale për prog. të parë
Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit			
1	Hortikulturë	700	126,000
2	Mbrojtje bimësh	700	126,000
3	Prodhim bimor	700	126,000
4	Zootekni dhe biznes blegtoral	700	126,000
5	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	700	126,000
6	Agromjedis dhe ekologji	700	126,000
7	Agromekanizëm	700	126,000
Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit			
8	Menaxhim agrobiznesi	750	135,000
9	Ekonomi dhe politikë agrare	750	135,000
10	Financë-kontabilitet	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Pyjore			
11	Mbarëshim pyjesh	700	126,000
12	Përpunim druri	700	126,000
Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit			
13	Teknologji agroushqimore	700	126,000
14	Vreshtari enologji	700	126,000

Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Financë	750	135,000
2	Administrim-biznes	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Natyrore			
3	Biologji	1,600	288,000
Fakulteti Histori-filologji			
4	Histori	850	153,000
5	Gjeografi	850	153,000
6	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Drejtësisë			
7	Drejtësi	550	99,000
Fakulteti i Shkencave Sociale			
8	Psikologji	850	153,000
9	Punë sociale	850	153,000
Universiteti Politeknik Inxh.Mek. (Eduk.distance)		1,800	324,000
Universiteti i Gjirokastrës Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
1	Cikli i ulët	850	153,000
2	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
3	Kontabilitet-financë	750	135,000
4	Administrim publik	750	135,000
5	Turizëm	750	135,000
6	Histori-gjeografi	850	153,000
7	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
8	Bio-kimi	1,700	288,000
9	Matematikë-fizikë	600	108,000
Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë			
10	Financë	750	135,000
11	Menaxhim	750	135,000
12	Marketing	750	135,000
13	Turizëm	750	135,000
14	Turizëm/Pogradec	750	135,000
Fakulteti i Mësuesisë			
15	Cikli i ulët	850	153,000
16	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
17	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Bujqësisë			
18	Agrobiznes	1,100	198,000
19	Hortikulturë	1,100	198,000
Universiteti i Elbasanit			
1	Punonjës social	850	153,000
2	Filozofi-sociologji	850	153,000
3	Gjuhë-letërsi	850	153,000
4	Histori-gjeografi	850	153,000
5	Edukatë qytetare	850	153,000
6	Financë-kontabilitet	750	135,000

7	Administrim-biznes	750	135,000
8	Cikli i ulët	850	153,000
9	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
10	Matematikë-fizikë	600	108,000
11	Biologji-kimi	1,700	288,000
Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Administrim-biznes	750	135,000
2	Financë-kontabilitet	750	135,000
3	Turizëm	750	135,000
Fakulteti i Drejtësisë			
4	Drejtësi	550	99,000
Fakulteti i shkencave të edukimit			
5	Cikli i ulët	850	153,000
6	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
Fakulteti i shkencave të natyrës			
7	Matematikë	600	108,000
8	Fizikë	600	108,000
9	Biologji-kimi	1,700	288,000
Fakulteti i shkencave shoqërore			
10	Gjuhë-letërsi	850	153,000
11	Histori	850	153,000
12	Gjeografi	850	153,000

Tabela nr.3. Tarifat e shkollimit për program të dytë studimi me kohë të pjesshme

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për prog. të dytë	Tarifë totale për prog të dytë
Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit			
1	Hortikulturë	1,300	234,000
2	Mbrojtje bimësh	1,300	234,000
3	Prodhim bimor	1,300	234,000
4	Zootekni dhe biznes blegtoral	1,300	234,000
5	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	1,300	234,000
6	Agromjedis dhe ekologji	1,300	234,000
7	Agromekanizëm	1,300	234,000
Fakulteti i ekonomisë dhe i agrobiznesit			
8	Menaxhim agrobiznesi	850	153,000
9	Ekonomi dhe politikë agrare	850	153,000
10	Financë-kontabilitet	850	153,000
Fakulteti i shkencave pyjore			
11	Mbarëshim pyjesh	1,300	234,000
12	Përpunim druri	1,300	234,000
Fakulteti i bioteknologjisë dhe i ushqimit			
13	Teknologji agroushqimore	1,300	234,000
14	Vreshtari biologji	1,300	234,000
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			

1	Financë	1,500	270,000
2	Administrim-biznes	1,500	270,000
Fakulteti i shkencave natyrore			
3	Biologji	1,300	234,000
Fakulteti Histori-Filologji			
4	Histori	1,500	270,000
5	Gjeografi	1,500	270,000
6	Gjuhë-letërsi	1,500	270,000
Fakulteti i Drejtësisë			
7	Drejtësi	1,500	270,000
Fakulteti i shkencave sociale			
8	Psikologji	1,500	270,000
9	Punë sociale	1,500	270,000
Universiteti Politeknik Inxh.Mek. (Eduk.distance)		2,000	360,000
Universiteti i Gjirokastrës Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
1	Cikli i ulët	1,100	198,000
2	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
3	Kontabilitet-financë	1,100	198,000
4	Administrim publik	1,100	198,000
5	Turizëm	1,100	198,000
6	Histori-gjeografi	1,100	198,000
7	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
Fakulteti i shkencave të natyrës			
8	Bio-kimi	1,100	198,000
9	Matematikë-fizikë	1,100	198,000
Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Financë	1,100	198,000
2	Menaxhim	1,100	198,000
3	Marketing	1,100	198,000
4	Turizëm	1,100	198,000
5	Turizëm/Pogradec	1,100	198,000
Fakulteti i mësuesisë			
6	Cikli i ulët	1,100	198,000
7	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
8	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
Fakulteti i bujqësisë			
9	Agrobiznes	1,100	198,000
10	Hortikulturë	1,100	198,000
Universiteti i Elbasanit			
11	Punonjës social	1,100	198,000
12	Filozofi-sociologji	1,100	198,000
13	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
14	Histori-gjeografi	1,100	198,000
15	Edukatë qytetare	1,100	198,000
16	Financë-kontabilitet	1,100	198,000
17	Administrim-biznes	1,100	198,000
18	Cikli i ulët	1,100	198,000

19	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
20	Matematikë-fizikë	1,100	198,000
21	Biologji-kimi		
Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Administrim-biznes	1,100	198,000
2	Financë-kontabilitet	1,100	198,000
3	Turizëm	1,100	198,000
Fakulteti i drejtësisë			
4	Drejtësi	1,100	198,000
Fakulteti i shkencave të edukimit			
5	Cikli i ulët	1,100	198,000
6	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
Fakulteti i shkencave të natyrës			
7	Matematikë	1,100	198,000
8	Fizikë	1,100	198,000
9	Biologji-kimi	1,100	198,000
Fakulteti i shkencave shoqërore			
10	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
11	Histori	1,100	198,000
12	Gjeografi	1,100	198,000

VENDIM

Nr.1114, datë 13.11.2009

PËR DHËNIEN E BURSIVE NXËNËSVE TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “PETER MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2009-2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr.9522, datë 25.4.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të 42 (dyzet e dy) bursave të studimit, nga të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) bursa studimi për nxënësit e viteve të para, 12 (dymbëdhjetë) bursa studimi për nxënësit e viteve të dyta dhe 14 (katërmëdhjetë) bursa studimi për nxënësit e viteve të treta të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2009-2010.

2. Vlera e bursës të jetë 680 (gjashtëqind e tetëdhjetë) euro për nxënë, në vit, për shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në drejtorinë arsimore rajonale, Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i “Fondacionit Shkollor Austriak”, në mbështetje të kriterëve ekonomike dhe të rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i “Fondacionit Shkollor Austriak”, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në drejtorinë arsimore rajonale, Shkodër, e cila pas konfirmimit të nxënësve, që përfitojnë bursë, e derdh vlerën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1115, datë 13.11.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E EKONOMISË DHE ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010, NË KËTË PROGRAM STUDIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.4, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në fakultetin e ekonomisë dhe administrimit, të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës në “Shkencat ekonomike”.

2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në shkencat ekonomike”.

3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

5. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 30, nga e cila dy kuota caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.1116, datë 13.11.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË “ARKITEKTURË
–URBANISTIKË”, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, TË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010, NË
KËTË PROGRAM STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës në “Arkitekturë-urbanistikë”.
 2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në arkitekturë-urbanistikë”.
 3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
 4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
 5. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 14, nga e cila dy kuota caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
 6. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.
 7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit Politeknik të Tiranës.
 8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1123, datë 13.11.2009

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.1035, DATË 9.7.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ÇAKTIMIN E TARIFËS SË LICENCIMIT TË
SUBJEKTEVE, NGA MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT, NË FUSHËN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE
TRANSPORTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.1035, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Nënndarja “A” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“A. Në fushën e punimeve të ndërtimit:

i. Licencë profesionale për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim.

ii. Licencë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e projektimit të veprave ndërtimore.”.

b) Në nënndarjen “B” shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“B. Certifikatë për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.”.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1124, datë 13.11.2009

**PËR LEJIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
GJYKATËN E LARTË, ME OBJEKTE “BLERJE DETEKTOR KONTROLI” DHE
“BOTIMET E VENDIMEVE TË GJYKATËS SË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Gjykatës së Lartë, që, brenda datës 31 dhjetor 2009, të përfundojë procedurat e prokurimit, me objekt:

a) “Blerje detektor kontrolli”;

b) “Botimet e vendimeve të Gjykatës së Lartë”.

Brenda këtij afati të përfshihen nënshkrimi dhe realizimi i kontratës.

2. Ngarkohen Gjykata e Lartë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1125, datë 13.11.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.954, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN, FUNKSIONIMIN E QENDRËS
NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD) DHE BASHKËVEPRIMIN
ME INSTITUCIONET SHTETËRORE, QË KANË INTERESA NË DET”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 3, pika 3, e 4/1, pika 3 të ligjit nr.8875, datë 4.4.2002 “Për rojën bregdetare shqiptare”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, 29 e 41 të ligjit nr.9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun III të vendimit nr.954, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “b” shfuqizohet.

b) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Oficerët e shërbimit/Oficerë civilë turni;”.

c) Shkronja “d” shfuqizohet.

2. Paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të pikës 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“- Koordinatorët institucionalë janë përfaqësues të caktuar nga institucionet shtetërore, që marrin pjesë në QNOD, dhe i përfaqësojnë ato gjatë planifikimit të përditshëm dhe afatgjatë operacional. Koordinatorët e caktuar nga institucionet pjesëmarrëse janë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planeve operacionale të QNOD-së, të miratuara bashkërisht, për vlerësimet e riskut, rekomandimet e trajnimit e të planit, sipas vendimeve përkatëse. Çdo institucion pjesëmarrës vendos sipas nevojave për numrin e koordinatorëve në QNOD.

- Oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit janë oficerët përgjegjës për personelin, që shërben në sallën operacionale të QNOD-së. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave do të kenë oficerë shërbimi, 24 orë, për marrjen e vendimeve në QNOD. Secili oficer shërbimi është përgjegjës për drejtimin e operacioneve, kompetencë e ministrisë që përfaqëson. Për sigurimin e kontrollit civil për të gjitha operacionet policore, oficeri i shërbimit, i caktuar nga Ministria e Brendshme në sallën operative të QNOD-së, do të marrë përsipër dhe do të ekzekutojë operacione, që lidhen me detyrat e policisë. Përgjegjësitë dhe bashkërendimi i oficerëve të shërbimit përshkruhen në procedurat operacionale, të miratuara.

- Personeli i operacioneve dhe ai i shërbimit të QNOD-së caktohen nga Ministria e Mbrojtjes dhe do të jenë operatorë të trajnuar radarësh dhe/ose personel për ndërlidhje. Personeli i shërbimit të QNOD-së do të shërbejë me turne shërbimi, për të garantuar se personeli është operativ çdo ditë, gjatë të gjithë ditës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1126, datë 13.11.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1694, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2009, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2009, për ministrinë dhe institucionet qendrore, bëhet 89 918 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i shtohen 18 (tetëmbëdhjetë) veta, për Qendrën Kombëtare të Aplikimeve Energjetike.

c) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Financave, i shtohen 3 (tre) veta, për njësinë e auditimit të sistemit të zbatimit të programeve të asistencës të Bashkimit Europian.

ç) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Këshillin e Ministrave, i shtohen 15 (pesëmbëdhjetë) veta, për Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit.

2. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e përmendura në shkronjat “b”, “c” e “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministrinë/Institucionet	Viti 2009
3	Kryeministria	143
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga e cila:	802
	- Drejtoria e Standardeve	18
	- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	135
	- Dr. Metereologjisë e Kalibrimit	110
	- Qendra Kombëtare e Licencimit	35
	- Qendra Kombëtare e Aplikimit të Energjisë	18
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit nga e cila:	2.198
	- Bordet e kullimit	650
	- Agjencia e pagesave	86
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1.363
10	Ministria e Financave nga e cila:	3206
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1.062
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1.616
	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	26
	- Agjencia e Lojërave të Fatit	25
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	39.231
	- Parauniversitar	38241

12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1.103
13	Ministria e Shëndetësisë	3530
14	Ministria e Drejtësisë nga e cila:	5026
	- Avokati i Shtetit	55
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	550
	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	150
	- Shërbimi i Provës	50
15	Ministria e Punëve të Jashtme	188
	Ambasadat dhe përfaqësitë	428
16	Ministria e Brendshme nga e cila:	13305
	-Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11779
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950
20	Dr. e Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	31
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale	1.434
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1.399
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	25
78	Ministria e Integritetit	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare nga e cila:	103
	- Dr. e Sigurimit të Informac. të Klasifikuar	38
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36
	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	- Agjencia Komb. Shoqërisë së Informacionit	20
	Total numri i punonjësve	86 743
	Numri i punonjësve në institucionet e pavarura	3 175

VENDIM
Nr.1127, datë 13.11.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS PEZË TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Pezë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Pezë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.528, datë 1.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Pezë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Pezë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Pezë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
13-17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
18-24	Varreza publike	Në pronësi
25-27	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
28-63,95-104.106	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
105,107-126,128-163,166,168-259	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
260-273	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

VENDIM
Nr.1128, datë 13.11.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DAJÇ TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dajç të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Dajç të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.125, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dajç të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Dajç për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4-8	Varreza publike	Në pronësi
9	Prona që përdoren për shërbime sociale.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
14-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
22	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
23-46	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
50,54,58,61,64,68,73,76,79,83,87,91,94,120	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive).	Në pronësi
97-111,145-152	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
116-119	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
121-130	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM**Nr.1129, datë 18.11.2009****PËR MIRATIMIN E STEMËS SË DREJTORISË SË SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25, pika 6 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e stemës së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sipas modelit të treguar në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1



Ana Para

Ana Prapa



VENDIM Nr.1130, datë 18.11.2009

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM, 2010-2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesën, 2010-2012, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM
Nr.1131, datë 13.11.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.825, DATË 28.12.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.825, datë 28.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në listën e anëtarëve të Këshillit të Statistikave, z.Florian Nuri zëvendësohet me z.Etion Kapedani.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1132, datë 13.11.2009

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 17 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Programit “Planifikim-Menaxhimit”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i pakësohet fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh.

b) Programit “Arsimi profesional”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i pakësohet fondi prej 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh.

c) Programit “Arsimi i lartë”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i pakësohet fondi prej 110 000 000 (njëqind e dhjetë milionë) lekësh.

ç) Programit “Arsimi bazë”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 283 000 000 (dyqind e tetëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1133, datë 18.11.2009

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “ADVISOR C. ENERGY”, SHPK, “POLISTAMP SYSTEM”, SRL, E “ENERGIA E TERRITORIO”, SRL, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “BJESHKË”, “VELESHICA 1”, “VELESHICA 2”, “VELESHICA 3”, “VELESHICA 4”, “VELESHICA 5”, “VELESHICA 6” DHE “SLLOVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Advisor C. Energy”, sh.p.k., “Polistamp System”, SRL, dhe “Energia e Territorio”, SRL, për ndërtimin e hidrocentraleve “Bjeshkë”, “Veleshica 1”, “Veleshica 2”, “Veleshica 3”, “Veleshica 4”, “Veleshica 5”, “Veleshica 6” dhe “Sllovë”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1135, datë 18.11.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SË KORPUSIT, NË BASHKINË E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës së Korpusit, në bashkinë e Shkodrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 724.4 (shtatëqind e njëzet e katër pikë katër) m², tokë truall, me vlerë 15 620 962 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 15 620 962 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e vitit 2009.

5. Edhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Shkodrës.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Shkodrës, për realizimin e projektit.

7. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 724.4 (shtatëqind e njëzet e katër pikë katër) m², tokë truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Shkodrës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS “KORPUSIT” NË BASHKINË E SHKODRËS

Nr.	Emër, mbiemër	Sip m ²	Çmimi lekë m ²	Vlera lekë	Dokum. i pronësisë	Zona kadast.
1	Teofik Cuciqi	91.8	21 564	1 979 575	Vërt. Pro.	9/386
2	Nikë e Prelë Vladaj	94.8	21 564	2 044 267	Vërt. Pro.	9/305
3	Murat Çekerku	180.5	21 564	3 892 302	Vërt. Pro.	9/357
4	Tring Kronaj	71.3	21 564	1 537 513	Vërt. Pro.	9/345
5	Adlije Cuciqi	190	21 564	4 097 160	Vërt. Pro.	10/112
	Zyhra Cuciqi					
	Qemal Cuciqi					
	Sami Cuciqi					
	Fatmira Cuciqi					
	Valbona Cuciqi					
	Zamir Cuciqi					
	Gentian Cuciqi					
	Mirsad Cuciqi					
	Fatbardha Cuciqi					
	Xhemalie Cuciqi					
	Ylvi Cuciqi					
	Gëzim Cuciqi					
	Artan Cuciqi					
	Burhan Cuciqi					
	Besmir Cuciqi					
	Rudina Cuciqi					
	Mimoza Cuciqi					
6	Eduard Çurçia	96	21 564	2 070 144	Vërt. Pro.	10/152
	Luigjina Çurçia					
	Eleonora Çurçia					
	Jozef Çoba					
	Alfons Çoba					
	TOTALI	724.4 m ²		15 620 962		

VENDIM
Nr.1136, datë 18.11.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS
SË TATIMEVE, NË BASHKINË E PEQINIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës së tatimeve, segmenti nga bulevardi “Mustafa Gjinishi”, deri tek unaza e qytetit, në bashkinë e Peqinit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Peqinit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 105.2 (njëqind e pesë pikë dy) m², tokë truall, dhe 105.2 (njëqind e pesë pikë dy) m², objekt, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 461 469.6 (dy milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Peqinit, planifikuar në buxhetin e vitit 2009.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet po nga bashkia e Peqinit.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Peqinit, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurive, përkatësisht 105.2 (njëqind e pesë pikë dy)m², tokë truall, dhe 105.2 (njëqind e pesë pikë dy) m² objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Peqinit, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Peqinit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS SË TATIMEVE, NË BASHKINË E
PEQINIT

Nr.	Emër, mbiemër	Sip. truall m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Dokum. i pronësisë	Zona kadast.
1	Familja Dervishi Agron, Anita, Zyra, Roland	105.2	2398	252269,6	Vërt. pron.	2908
	Shuma	105.2		252269.6		
	Emër, mbiemër	Sip. objekt m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Dokum. i pronësisë	Zona kadast.
2	Familja Dervishi Agron, Anita, Zyra, Roland	105.2	21000	2209200	Vërt. pron.	2908
	Shuma	105.2		2209200		
	TOTALI			2461469,6		

VENDIM
Nr.1137, datë 18.11.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.933, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRFAQËSIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME ME OFICERË KONTAKTI NË BRITANINË E MADHE, BELGJIKË, ITALI, GREQI, TURQI, KOSOVË, SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS, GJERMANI, FRANCË DHE EUROPOL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.933, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Francë, EUROPOL dhe INTERPOL”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti, pranë Shërbimit Policor European-EUROPOL dhe Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale-INTERPOL.”

c) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Sistemimi me zyra i oficerëve të kontaktit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të bëhet në mjediset e përfaqësive tona diplomatike, ndërsa zyra e oficerit të kontaktit në EUROPOL do të jetë në zyrat qendrore të EUROPOL-it, në Hagë, dhe zyra e oficerit të kontaktit në INTERPOL do të jetë në zyrat qendrore të INTERPOL-it, në Lion.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1177, datë 25.11.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIM DHE NDIHMË TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në çështjet doganore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI BASHKËPUNIMIN DHE NDIHMËN RECIPROKE NË ÇËSHTJET DOGANORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Kosovës këtej e tutje të referuara si “Palë kontraktuese”;

duke pasur parasysh se shkeljet ndaj legjislacionit doganor janë të dëmshme për sigurinë e palëve dhe për interesat e tyre ekonomikë, fiskalë, shoqërorë dhe kulturorë;

duke vlerësuar se trafikimi i paligjshëm i narkotikëve, drogave dhe substancave psikotropike, përbën një rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

duke pasur parasysh kërcënimin e krimit të organizuar ndërkombëtar dhe grupet terroriste me burimet e tyre thelbësore, si dhe nevojën për luftimin e tyre në mënyrë efektive;

duke pasur parasysh rëndësinë e vlerësimit të saktë të detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera të grumbulluara në eksportimin ose importimin e mallrave, duke përfshirë edhe përcaktimin e saktë të vlerës dhe origjinës së mallrave, si dhe sigurimin e ushtrimit të duhur të masave mbi ndalimin, kufizimin dhe kontrollin;

të bindur se përpjekjet për të parandaluar shkeljet e legjislacionit doganor dhe përpjekjet për të siguruar mbledhjen e saktë të detyrimeve të importit dhe eksportit, taksave dhe detyrimeve të tjera, do të bëhen më efektive nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet autoriteteve të tyre doganore, bazuar në dispozita të qarta ligjore;

duke marrë në konsideratë nevojën për thjeshtëzimin e formaliteteve doganore dhe kontrollit të mallrave, të pasagjerëve dhe ngarkesave;

duke pasur parasysh nxitjen e instrumenteve ndërkombëtare dypalëshe të ndihmës së dyanshme, dhe në veçanti të rekomandimit të Këshillit të Bashkëpunimit Doganor (njohur si Organizata Botërore e Doganave) të datës 5 dhjetor 1953 mbi asistencën e ndërsjellë doganore;

duke pasur parasysh dispozitat e konventës mbi narkotikët e vitit 1961, e ndryshuar, dhe të konventës mbi substancat psikotropike të vitit 1971, e ndryshuar, e hartuar nën kujdesin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si dhe konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotropike të vitit 1988;

duke marrë në konsideratë gjithashtu konventat ndërkombëtare detyruese për të dyja palët dhe që përmbajnë ndalime, kufizime dhe masa të veçanta kontrolli lidhur me mallra specifike;

duke pasur parasysh edhe marrëdhëniet ekzistuese kontraktuale midis palëve kontraktuese dhe Bashkimit Europian,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “legjislacioni doganor” do të thotë tërësia e dispozitave ligjore dhe nënligjore të detyrueshme për t’u zbatuar nga autoritete doganore në lidhje me importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave dhe mjetet e pagesës që kanë të bëjnë me detyrimet doganore, apo detyrime të tjera që vihen nga autoritetet e doganave, apo me masat kufizuese, ndaluese të kontrollit të këtyre mallrave;

b) “shkelje doganore” nënkupton kundërvajtje administrative doganore dhe kontrabandën në fushën doganore që kanë si qëllim shkeljen e legjislacionit doganor;

c) “autoritet doganor” do të thotë për Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe për Republikën e Kosovës, Shërbimi Doganor Kosovar/doganat e Kosovës;

d) “autoritet kërkues” do të thotë autoriteti kompetent doganor i një pale, i cili bën një kërkesë për ndihmë në fushën e çështjeve doganore në përputhje me këtë marrëveshje;

e “autoritet i kërkuar” do të thotë autoriteti doganor i një pale, i cili merr një kërkesë për ndihmë në çështjet doganore;

f) “dërgim i kontrolluar” do të thotë metoda e lejimit të ngarkesave të paligjshme për të hyrë, dalë ose lëvizur përmes ose në territoret e palëve kontraktuese, me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve të tyre kompetente, me qëllim të zbulimit dhe identifikimit të personave të përfshirë në kryerjen e shkeljeve të legjislacionit doganor;

g) “të dhëna personale” do të thotë çdo informacion apo e dhënë në lidhje me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm;

h) “narkotikët” (drogat) do të thotë çdo substancë, natyrore ose sintetike, në listat I dhe II të konventës së vetme të narkotikëve, të vitit 1961, të ndryshuar, si dhe çdo substancë e asimiluar e narkotike (drogave) në legjislacionin kombëtar;

i) “substancat psikotropike dhe prekursorët” do të thotë çdo substancë natyrore ose sintetike, ose ndonjë material natyror në listat I, II, III dhe IV të konventës mbi substancat psikotropike, të vitit 1971, të ndryshuar, si dhe çdo substancë e asimiluar në substanca psikotropike në legjislacionin kombëtar;

j) “shenja paralajmëruese” do të thotë substanca kimike të listuara në aneksin e konventës së OKB-së së vitit 1988, të ndryshuar;

k) “informacion” do të thotë, *inter-alia*, të dhëna, raportet, dokumentet, si dhe dokumentacion i kompjuterizuar ose jo, gjithashtu kopje të këtyre dokumenteve të njësuara me origjinalin.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Palët kontraktuese, nëpërmjet autoriteteve të tyre doganore dhe në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë;

a) në mënyrë që të sigurohet zbatimi i saktë i legjislacionit doganor;

b) me qëllim parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve të legjislacionit doganor;

c) në lidhje me njoftimin e dokumenteve me qëllim zbatimin e legjislacionit doganor.

2. Ndihma në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e kërkuar të palës kontraktuese dhe brenda kompetencave dhe burimeve në dispozicion të autoritetit doganor të kërkuar. Nëse është e nevojshme, autoriteti doganor mund të ofrojë një ndihmë të siguruar përmes një autoriteti tjetër kompetent.

3. Kjo Marrëveshje nuk parashikon kthimin e detyrimeve, taksave dhe çdo ngarkesë tjetër në emër të palës tjetër kontraktuese.

4. Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi ndihmën ligjore në çështjet penale në të cilat kanë hyrë palët kontraktuese.

Neni 3

Rastet e ndihmës

1. Autoritetet doganore, me nismën e tyre ose sipas kërkesës, do ta furnizojnë njëra-tjetrën me të gjitha informacionet, të cilat mund të ndihmojnë në saktësinë e informacionit të siguruar për:

a) mbledhjen e detyrimeve të importit dhe eksportit, taksat apo detyrimet e tjera që vihen nga autoritetet doganore dhe në veçanti, të dhëna të cilat mund të ndihmojnë për të vlerësuar vlerën e mallrave për qëllime doganore dhe për të vendosur klasifikimin tarifor të tyre;

b) zbatimin e dispozitave në lidhje me ndalimet, kufizimet dhe kontrollin;

c) zbatimin e rregullave të origjinës që nuk mbulohen nga marrëveshjet preferenciale vendosur nga një ose që të dy prej palëve kontraktuese.

2. Nëse autoriteti doganor i kërkuar nuk posedon/disponon informacionin e kërkuar, ai do të kërkojë informacion me të gjitha mjetet në dispozicion, në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi në territorin e kërkuar të palës kontraktuese.

3. Autoriteti doganor i kërkuar do të kërkojë informacion sikur të kishte vepruar në bazë të llogarisë së vet.

4. Në rast se autoriteti doganor i kërkuar nuk është autoriteti kompetent në përputhje me kërkesën, ai, pas konsultimit të duhur, duhet që menjëherë kërkesën t'ia përcjellë autoritetit kompetent që do të veprojë sipas kërkesës në bazë të kompetencave të tij sipas ligjit, ose të këshillojë autoritetin doganor që ka kërkuar ndihmë për procedurën e duhur që duhet ndjekur në lidhje me një kërkesë të tillë.

5. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese, në përputhje, pa rënë ndesh me legjislacionin kombëtar, mund të kërkojnë bashkëpunim në:

a) inicimin, zhvillimin apo përmirësimin e programeve specifike të trajnimit për personelin e tyre;

b) krijimin dhe mbajtjen e kanaleve të komunikimit midis tyre për lehtësimin e shkëmbimit të shpejtë dhe të sigurt të informacionit;

c) tendencat dhe testimin e pajisjeve dhe procedurave të reja;

d) çdo çështje tjetër administrative që mund të kërkohet kohë pas kohe për aktivitetin e tyre të përbashkët, duke përfshirë edhe mundësinë e shkëmbimit të personelit dhe të ekspertëve.

Neni 4

Shkëmbimi i informacionit mbi mallrat dhe procedurat

Autoritetet doganore duhet që, sipas kërkesës, ta furnizojnë njëra-tjetrën me çdo informacion që tregon se:

a) mallrat e importuara që janë në territorin e një pale kontraktuese janë eksportuar në mënyrë të ligjshme nga territori i palës tjetër kontraktuese;

b) mallrat e eksportuara nga territori i një pale kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin e palës tjetër kontraktuese, duke specifikuar nëse është e nevojshme, llojin e procedurës doganore të aplikuar mbi këto mallra;

c) mallra të cilat janë dhënë me trajtim favorizues pas eksportimit nga territori i një pale kontraktuese kanë qenë siç duhet të importuara në territorin e palës tjetër kontraktuese, kjo kuptohet se informacioni duhet gjithashtu të sigurohet për çdo masë të kontrollit doganor të mallrave të cilat kanë qenë të nënshtruara.

Neni 5

Informacioni në rast shkeljesh

Autoritetet e doganave, me nismën e tyre ose sipas kërkesës, do ta furnizojnë njëra-tjetrën me të gjithë informacionin që mund të jetë i nevojshëm dhe që ka të bëjë me shkeljet e legjislacionit doganor dhe në veçanti, në lidhje me:

a) personat fizikë ose juridikë që janë të njohur ose të dyshuar si kundërvajtës që kanë kryer shkelje të legjislacionit doganor në fuqi në territorin e një pale tjetër kontraktuese;

b) mallrat e njohura apo të dyshuara, që mund të jenë subjekt i trafikut të paligjshëm;

c) mjetet e transportit dhe kontenerët të njohur ose të dyshuar, që mund të përdoren në shkeljen e legjislacionit doganor në fuqi në territorin e një pale tjetër kontraktuese;

d) mënyrat e reja, që do të thotë të jenë të njohura ose të dyshuara për momentin, të punësuar në kundërshtim me legjislacionin doganor. Çdo kërkesë për arrestimin e personave do të përjashtohet nga një ndihmë e tillë.

Neni 6

Shkëmbimi i dokumentacionit

Autoriteti doganor i një pale kontraktuese, me iniciativën e vet ose me kërkesë, do ta furnizojë autoritetin doganor të palës tjetër kontraktuese me raporte, të dhëna ose kopje të njësuara me origjinalin e dokumenteve duke i dhënë informacion mbi të gjitha transaksionet që janë në dispozicion, të përfunduara ose të planifikuara, të cilat përbëjnë ose mund të përbëjnë një shkelje në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi në territorin e asaj pale kontraktuese.

Neni 7
Informacioni elektronik

Dokumentet e parashikuara në këtë Marrëveshje mund të zëvendësohen me informacion të kompjuterizuar, të prodhuar në ndonjë formë tjetër për të njëjtin qëllim. I gjithë informacioni i duhur për interpretimin ose shfrytëzimin e materialit duhet të plotësohet në të njëjtën kohë.

Neni 8
Përdorimi i dokumenteve origjinale dhe kopje

1. Autoritete doganore do të kërkojnë dokumente të njësuar me origjinalin. Në rastet kur kopjet e këtyre dokumenteve të njësuar me origjinalin do të jenë të pamjaftueshme, autoritetet doganore do të kërkojnë dokumentet origjinale.

2. Dokumentet origjinale të marra nga autoriteti doganor i palëve të tjera kontraktuese do të kthehen në rastin e parë të mundshëm. Në momentin e kërkesës, origjinalet e nevojshme për verifikim apo qëllime të ngjashme, do të kthehen pa vonesë.

Neni 9
Mbikëqyrja e personave, mallrave dhe mjeteve të transportit

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese, me nismën e tyre ose sipas kërkesës, do të mbajnë nën mbikëqyrje doganore:

a) personat e njohur ose të dyshuar, kundërvajtësit e legjislacionit doganor të palëve të tjera kontraktuese;

b) lëvizjen e mallrave dhe mjeteve për pagesë, të cilat janë raportuar nga ana e autoriteteve doganore të palëve të tjera kontraktuese, duke i dhënë të drejtë për të dyshuar për trafikim të paligjshëm në ose përmes territorit të tij;

c) çdo mjet i transportit i cili është i njohur për të ose i dyshuar apo përdorur në kundërvajtjen doganore të legjislacionit në fuqi në territorin e palëve të tjera kontraktuese;

d) vende të përdorura për magazinimin e mallrave, të cilat mund të përbëjnë trafikun e paligjshëm thelbësor në territorin e palës tjetër kontraktuese.

2. Brenda kompetencave të tyre, autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të parandalojnë:

a) eksportimin e mallrave të cilat janë të njohura për të ose në baza të arsyeshme, të dyshuara e të qenët të eksportuara në territorin e palës tjetër kontraktuese që do të përdoret për qëllime të tjera të paligjshme në tregtinë midis palëve kontraktuese;

b) eksportimin e mallrave, importi i të cilave është i ndaluar në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 10
Dërgimi i kontrolluar

1. Autoritetet doganore, me pëlqimin e ndërsjellë dhe brenda kompetencave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar të secilit shtet, mund të lejojnë përdorimin e metodës së dërgimit të kontrolluar, në mënyrë që të identifikohen personat e përfshirë në një kundërvajtje. Kur një vendim për përdorimin e metodës së dërgimit të kontrolluar nuk është në kompetencë të autoriteteve doganore, atëherë autoritetet doganore do të fillojnë bashkëpunimin me autoritetet e tjera kombëtare që kanë kompetenca të tilla ose transferimin e rastit tek ai autoritet.

2. Ngarkesat e paligjshme, për të cilat është rënë dakord që mund të kontrollohen, me pëlqimin e autoriteteve kompetente kombëtare, të zbuluara dhe të lejohet të vazhdojë me mallra të paprekura ose largohen dhe konfiskohen, ose zëvendësohet në tërësi ose pjesërisht.

3. Vendimet lidhur me përdorimin e dërgesave të kontrolluara që do të merren rast pas rasti, dhe nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh marrëveshjet financiare dhe mirëkuptimin.

Neni 11

Veprimet kundër trafikut të paigjshëm të mallrave

Autoritetet doganore, me nismën e tyre ose sipas kërkesës dhe pa vonesë, do të furnizojnë njëra-tjetrën me çdo informacion që disponojnë, mbi trafikut e paligjshme apo çdo aktivitet tjetër që përbën ose dyshohet se përbën një shkelje të legjislacionit doganor në fuqi në territorin e njëres prej palëve kontraktuese lidhur me:

- a) lëvizjen e armëve, municioneve dhe eksplozivëve;
- b) lëvizjen e mallrave strategjikë dhe sensitivë, që u nënshtrohen kontrolleve të posaçme, në përputhje me traktatet ndërkombëtare në fjalë dhe të marrëveshjeve përkatëse multilaterale dhe bashkëpunimit për mospërhapjen e detyrimeve;
- c) lëvizjes së lëndëve narkotike (drogave), substancave psikotrope dhe shenjave paralajmëruese;
- d) lëvizjen e veprave të artit, antikave dhe pasurive të tjera kulturore të cilat janë të rëndësishme për arkeologjinë, parahistorinë, historinë, literaturën, artin dhe shkencën, sipas parimeve të paragrafëve “a”-“k” të nenit 1 të konventës UNESCO lidhur me kufizimin dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transportimin e vlerave kulturore, për aq kohë sa vepra e artit, antikat dhe pasuritë e tjera kulturore të jenë subjekt kontrabande dhe operacionet financiare të ndërmarra lidhur me këtë kontrabandë të cenojnë vlerën historike, kulturore ose arkeologjike për njërin prej palëve kontraktuese;
- e) lëvizjen e mallrave/lëndëve helmuese, si dhe mallrave apo substancave të rrezikshme për mjedisin ose për shëndetin;
- dh) lëvizjen e mallrave që janë subjekt i detyrimeve të larta të taksave apo ngarkesave të tjera fiskale, e në veçanti, të mallrave për të cilat paguhet akcizë.
- g) lëvizjen e mallrave që cenojnë të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale.

Neni 12

Hetimet

1. Bazuar në kërkesën e njëres palë kontraktuese, pala tjetër do të fillojë hetime zyrtare lidhur me operacione, të cilat janë ose mund të jenë në kundërshtim me legjislacionin doganor në fuqi në territorin e kërkuar të palës kontraktuese. Ajo duhet të komunikojë rezultatet e hetimeve të tilla tek autoriteti doganor që i ka kërkuar.

2. Hetimet e tilla duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e kërkuar të palës kontraktuese. Autoriteti doganor i kërkuar do të veprojë sikur të ishte duke vepruar në llogarinë e vet.

3. Autoriteti doganor i kërkuar mund të lejojë zyrtarët e autoritetit doganor kërkues të jenë të pranishëm në hetimet e tilla, kur shkelësit e legjislacionit doganor të palës kërkuese janë duke u hetuar.

Neni 13

Ekspertët dhe dëshmitarët

1. Me kërkesën e një pale kontraktuese, në lidhje me shkeljet e legjislacionit doganor, autoriteti doganor i kërkuar mund të autorizojë zyrtarët e vet brenda kufizimeve të autorizimit të dhënë, për të dalë si ekspertë apo dëshmitarë në procedimet gjyqësore ose administrative në territorin e palës kontraktuese të kërkuar. Zyrtarët e tillë do të japin dëshmi lidhur me faktet e krijuara gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Kërkesa për paraqitje/veprim duhet të përcaktojë qartë çështjen dhe statusin në të cilin do të dëshmojë/do të veprojë zyrtari.

2. Zyrtari i kërkuar që paraqitet si ekspert ose dëshmitar, ka të drejtë të refuzojë, të japë dëshmi ose një deklaratë, në qoftë se e drejta e refuzimit i lind në mbështetje të legjislacionit të shtetit të tij apo të palës tjetër kontraktuese.

Neni 14

Marrëveshjet për vizita zyrtare

Kur, në rrethanat e ofruara nga kjo Marrëveshje, zyrtarët e autoritetit doganor të një pale kontraktuese janë të pranishëm në territorin e palës tjetër kontraktuese, ata në çdo kohë duhet të jenë në gjendje të japin dëshmi për cilësinë e tyre zyrtare. Ata duhet të mos jenë në uniformë dhe as të mbajnë armë. Ata gëzojnë të njëjtën mbrojtje si zyrtarët e tjerë të doganave të palës kontraktuese, në përputhje me ligjet në fuqi atje dhe do të jenë përgjegjës për ndonjë krim që ata mund të kryejnë.

Neni 15

Përdorimi i dokumenteve dhe informacionit

1. Informacione, dokumente dhe komunikime të tjera të marra sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përdoren për qëllime të tjera, përveç atyre të specifikuara në këtë Marrëveshje apo të transmetohen më tej, pa pëlqimin me shkrim të autoriteteve doganore respektive, e cila e furnizon dhe do të jetë subjekt i kufizimeve të përcaktuara nga ndonjë autoritet. Këto dispozita nuk janë të aplikueshme për rastet e informatave, dokumenteve dhe të tjera në lidhje me kontradiktat, komunikimet etj., me drogat dhe substancat psikotropike. Informacione të tilla mund të jenë objekt i komunikimit mes autoriteteve të tjera të përfshira drejtpërdrejt në luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogave dhe substancave psikotropike.

2. Informacioni i siguruar në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të jetë i natyrës konfidenciale. Ai duhet të jetë i mbuluar nga detyrimi i sekretit profesional dhe do të gëzojë mbrojtjen e parashikuar për të njëjtin lloj informacioni dhe dokumentacioni në bazë të legjislacionit në fuqi në territorin e palës kontraktuese e cila mori atë.

3. Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të pengojë përdorimin e informacionit në procedimet civile, penale ose administrative, nëse diçka e tillë nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit kombëtar respektiv.

4. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese në përputhje me qëllimet dhe brenda fushës së kësaj Marrëveshjeje, mund të paraqesin si provë në gjykatë regjistrat e të dhënave, raportet, informacionin dhe dokumentet e marra në pajtim me këtë Marrëveshje, si dhe dëshmitë përkatëse.

5. Përdorimi i këtyre informacioneve, dokumenteve si dhe dëshmimeve në gjykata do të ketë vlerën e provës sipas përcaktimeve në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 16

Trajtimi i të dhënave personale

Legjislacioni në fuqi në territoret e palëve kontraktuese do të jetë i aplikueshëm për trajtimin e të dhënave personale të shkëmbyera në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe për të drejtat e të dhënave të përshkruara si më poshtë:

a) Të dhënat personale që merren në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi në territoret e palëve kontraktuese.

b) Të dhënat personale nuk do të transmetohen në qoftë se transferimi do të jetë në kundërshtim me dispozitat ligjore të njëres prej palëve kontraktuese, si dhe me dispozitat ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave, në mënyrë të veçantë. Asnjë kërkesë nuk mund të injorohet në rastet kur mund të konsiderohet se transmetimi i të dhënave mund të shkaktojë shqetësim për personin në fjalë. Në momentin e marrjes së kërkesës nga autoriteti doganor, ky i fundit do të informojë autoritetin doganor kërkuar të informacionit për rezultatet e arritura.

c) Autoritetet e doganave mund të transmetojnë të dhënat personale tek autoritetet e tjera vetëm për zbatimin e ligjit dhe në rast se është e nevojshme për qëllime të ndjekjes penale, për të

publikuar ndjekjen penale dhe për autoritetet gjyqësore. Një informacion i tillë nuk do t'u komunikohet autoriteteve të tjera, vetëm në qoftë se autoritetet e doganave furnizuese shprehimisht bien dakord, dhe ligji që rregullon autoritetet të cilat i lejon të marrin të dhënat e tilla të komunikimit.

d) Furnizimi i autoritetit doganor duhet të përcaktojë vlefshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave personale që do të paraqiten. Në rast se autoriteti doganor furnizues i gjen të dhënat personale që janë dorëzuar, të pasakta apo të kufizuara, ai duhet ta informojë autoritetin respektiv doganor që ta marrë në konsideratë këtë fakt pa vonesë. Autoriteti doganor që merr të dhënat personale apo si dhe autoritete të tjera që kanë marrë këto të dhëna, do të shkatërrojnë ose fshijnë të dhënat personale pa vonesë.

e) Autoriteti doganor që merr të dhënat, duhet të japë informacion mbi afatin kohor të kërkuar në lidhje me të dhënat e shuara sipas legjislacionit të shtetit të tij. Të dhënat personale të fshihen sa më shpejt sipas propozimit për të cilin të dhënat personale mund të përdoren në pajtim me këtë Marrëveshje.

f) Autoritetet doganore respektive do të mbajnë një regjistër të të dhënave personale të dërguara apo të pranuar.

g) Autoritetet doganore duhet të marrin masa për të siguruar që të dhënat personale të mos jepen në mënyrë të paautorizuar, të jenë objekt modifikimi, shkatërrimi, dëmtimi ose transmetimi të paautorizuar, si dhe i veprimeve të tjera të paautorizuara të përpunimit ose keqpërdorimit.

h) Trajtimi i të dhënave personale të dërguara në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të mbikëqyren nga autoritetet kombëtare të mbrojtjes së të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi në territoret e palëve kontraktuese.

Neni 17

Njoftimi i dokumenteve

1. Me kërkesë të njëres palë kontraktuese, pala tjetër kontraktuese do të njoftojë personat fizikë apo juridikë në fjalë, që banojnë ose janë të vendosur në territorin e saj, për dokumentet që kanë të bëjnë me masat dhe vendimet e marra ndaj tyre, në zbatim të legjislacionit doganor.

2. Njoftimi i dokumenteve do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të palës që jep informacion. Njoftimi i dokumenteve mund të bëhet gjithashtu me anë të një formulari të veçantë përcjellës, me kusht që përmbajtja e kësaj kërkesë të mos jetë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të palëve kontraktuese.

3. Marrja e njoftimit mund të marrë formën e një njohjeje të nënshkruar, ku të ketë edhe datën e marrjes nga ana e personit në fjalë ose mund të jetë në formën e një certifikate të autoritetit kompetent, bazuar në kërkesën e palëve kontraktuese, duke treguar metodën dhe datën e njoftimit.

Neni 18

Forma dhe përmbajtja e kërkesave për ndihmë

1. Kërkesat në bazë të kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim dhe do të shoqërohen me çdo dokument të nevojshëm për përmbushjen e kërkesave të tilla. Për shkak të situatës së urgjencës, kërkesa mund të bëhet gojarisht, me kusht që menjëherë sapo të jetë e mundur, kjo kërkesë të bëhet edhe me shkrim.

2. Kërkesat, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përfshijnë elementet e mëposhtme:

- a) autoritetin doganor kërkuar;
- b) masat e kërkuara;
- c) objektin dhe arsyen e kërkesës;
- d) ligjet, rregullat dhe elemente të tjera ligjore të përfshira;
- e) gjeneralitetet e plota, aq sa është e mundur, për personat fizikë ose juridikë që janë objekt të hetimeve;
- f) një përmbledhje të fakteve përkatëse, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 17.

3. Kërkesat duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër të pranueshme për të kërkuar nga autoriteti doganor.

4. Nëse një kërkesë nuk i përmbush kërkesat formale, autoriteti doganor i kërkuar mund të kërkojë korrigjim ose plotësim të tij, ose të marrë masa parandaluese.

Neni 19

Përfshirjet nga detyrimi për të siguruar ndihmë

1. Nëse autoriteti doganor i një pale kontraktuese konsideron se dhënia e ndihmës do të jetë në dëm të sovranitetit, sigurisë, rendit publik, politikave publike, parimeve bazë të sistemit juridik të brendshëm të saj apo të tjera që mund të dëmtojnë interesat thelbësore të shtetit, ose që do të përbënte një shkelje industriale, tregtare ose profesionale të fshehtë, autoriteti doganor mund të refuzojë të japë ndihmë ose ta afrojë atë pjesërisht, ose ajo t'u nënshtrohet disa kushteve apo kërkesave.

2. Nëse ndihma është refuzuar, vendimi dhe arsyet e refuzimit duhet të njoftohen me shkrim tek autoriteti doganor kërkuar pa vonesë.

3. Ndihma mund të shtyhet nga autoriteti doganor i kërkuar nëse ajo bazohet në faktin se ndërhyrja në një proces hetimi, ndjekje ose procedim të papërfunduar. Në një rast të tillë kërkohet që autoriteti doganor të konsultohet me autoritetin doganor kërkuar për të kërkuar nëse ndihma mund të jepet sipas termave apo kushteve që mund të vihen nga autoriteti doganor i kërkuar.

4. Nëse autoriteti doganor i një pale kontraktuese kërkon ndihmë, të cilën ai vetë nuk mund ta përmbushë nëse diçka e tillë do t'i kërkohej atij vetë, kjo duhet të theksohet në kërkesë. Kërkesa e paraqitur duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 20

Shpenzimet

1. Autoritetet doganore do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursimin e kostove të dala gjatë ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje, përveç shpenzimeve dhe dietave paguar ekspertëve dhe dëshmitarëve, si dhe kostot e përkthyesve dhe interpretuesve që nuk janë punonjës qeveritarë, këto do të mbulohen nga administrata kërkuar.

2. Nëse ka apo kërkohen shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme për ekzekutimin e kërkesës, palët kontraktuese do të konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mënyrën se si do të përballohen shpenzimet.

Neni 21

Shkëmbimi i ndihmës

1. Për ndihmën e dhënë sipas kësaj marrëveshjeje, autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të furnizohen direkt mes tyre.

2. Autoritetet doganore do të marrin masa që punonjësit e tyre përgjegjës për investigimin apo luftën ndaj shkeljeve doganore të mbajnë lidhje direkte dhe personale me njëra-tjetrën. Mund të instruktojnë organet vartëse të tyre që të jenë në komunikim të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën.

Një listë e zyrtarëve të caktuar për këtë qëllim nga çdo autoritet doganor, do të dërgohet në administratën doganore të palës tjetër kontraktuese.

Neni 22

Zbatueshmëria territoriale, zbatimi dhe interpretimi

1. Kjo marrëveshje do të jetë e aplikueshme në territoret doganore të të dyja palëve kontraktuese, siç përcaktohet në dispozitat e tyre kombëtare kushtetuese, ligjore dhe administrative.

2. Autoritetet doganore do të vendosin mbi rregullimet e detajuara për lehtësimin e zbatimit

të kësaj marrëveshjeje.

3. Autoritetet doganore do të zgjidhin me marrëveshje reciproke çdo problem apo dyshim të dalë nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje. Mosmarrëveshjet për të cilat nuk është gjetur zgjidhje, do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 23

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pasi palët kontraktuese ta kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike se kërkesat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë plotësuar.

2. Kjo marrëveshje është parashikuar për një kohëzgjatje të pakufizuar, por secila nga palët kontraktuese mund ta përfundojë atë në çdo kohë me anë të njoftimit nëpërmjet kanaleve diplomatike.

3. Përfundimi do të ketë efekte tre muaj nga data e dërgimit të njoftimit të denoncimit të pala tjetër kontraktuese. Procedimet në vazhdim në kohën e përfundimit do të mbyllen detyrimisht në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

4. Palët kontraktuese do të takohen me qëllim rishikimin e kësaj marrëveshjeje sipas kërkesës ose në fund të pesë vjetëve nga data e hyrjes në fuqi, nëse nuk njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim se një rishikim i tillë është i panevojshëm.

Dëshmitarë për sa më sipër të poshtëshënuarit, të autorizuar përkatësisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Prishtinë, më datë 6.10.2009, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, duke qenë të gjitha tekstet njëloj të vlefshme. Në rast mospërputhjeje në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM

Nr.1180, datë 3.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT TË AUTORIZUAR PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR “LOTARI KOMBËTARE” DHE TË LICENCEVE PËR “KAZINO”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 pika 2, 27, pika 1, e 33 pika 2 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti i autorizuar për dhënie e licencës për “Lotari kombëtare” dhe të licenceve për “Kazino” është Ministria e Financave.

2. Autorizohet Ministria e Financave për shpalljen e procedurave të garës për “Lotari kombëtare”, si dhe për shpalljen e kriterëve për dhënie e licenceve për “Kazino”.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1181, datë 3.12.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.366, DATË 15.4.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KOMPENSIMIN E PAGESËS PËR PAJISJEN ME LETËRNJOFTIM
TË SHITESAVE NË NEVOJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 42 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.11 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e viti 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 7 të vendimit nr.366, datë 15.4.2009 të Këshillit të Ministrave shifra “... 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë...” zëvendësohet me “... 617 500 000 (gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë...”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1183, datë 3.12.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË TRETË, “MASTER I
NIVELIT TË DYTË”, NË INSTITUTIN E STUDIMEVE EUROPIANE NË UNIVERSITETIN
E TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË
SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimit, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në Institutin e Studimeve Europiane të Universitetit të Tiranës, në:

- a) Legjislacion dhe institucionet europiane;
- b) Politika dhe qeverisja në Europë;
- c) Diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Bashkimit Europian (BE).

Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND) në fushën e arsimimit të kryer.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010, janë si më poshtë vijon:

- a) Legjislacion dhe institucionet europiane 30 kuota;
- b) Politika dhe qeverisja në Europë 30 kuota;
- c) Diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Bashkimit Europian. 30 kuota.

5. Nga kuotat e mësipërme të çdo programi studimi, 9 kuota janë për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

6. Tarifa e shkollimit, për studentët e regjistruar në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010, është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, e cila likuidohet me këste të caktuara nga instituti përkatës.

8. Studentët shqiptarë, që kanë kryer me rezultate të shkëlqyera ciklin paraardhës të studimeve, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.1184, datë 3.12.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË UNIVERSITETIN E TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimit të ciklit të dytë në:

a) “Infermieri”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program.

b) “Teknik laborator”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program.

c) “Fizioterapi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program;

ç) “Teknik imazherie”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program;

d) “Mami”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program.

2. Programet e studimit të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-

2010, të jenë, si më poshtë vijon:

- | | |
|---------------------|------|
| a) Infermieri | 100; |
| b) Teknik laborator | 25; |
| c) Fizioterapi | 25; |
| ç) Teknik imazherie | 25; |
| d) Mami | 25. |

5. Kuota e pranimit, në këto programe studimi, për ata studentë, që i ndjekin këto programe si programe të dyta studimi të jetë, si më poshtë vijon:

- | | |
|---------------------|-----|
| a) Infermieri | 10; |
| b) Teknik laborator | 3; |
| c) Fizioterapi | 3. |

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

- | | |
|---------------------|---------------|
| a) Infermieri | 100 000 lekë; |
| b) Teknik laborator | 100 000 lekë; |
| c) Fizioterapi | 100 000 lekë; |
| ç) Teknik imazherie | 100 000 lekë; |
| d) Mami | 100 000 lekë. |

7. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që i ndjekin këto programe, si programe të dyta studimi, të ciklit të dytë, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

- | | |
|---------------------|---------------|
| a) Infermieri | 200 000 lekë; |
| b) Teknik laborator | 200 000 lekë; |
| c) Fizioterapi | 200 000 lekë; |
| ç) Teknik imazherie | 200 000 lekë; |
| d) Mami | 200 000 lekë. |

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1185, datë 3.12.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në “Inxhinieri mekanike”, me këto profile:

- a) Inxhinieri mekanike, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore

“Doktor (Dr.) në inxhinieri mekanike”.

b) Inxhinieri materiale, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri mekanike”, me profil inxhinieri materiale.

2. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009 - 2010.

3. Kohëzgjatja e programit të mësipërm të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 14.

5. Nga kuota e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, caktohen dy kuota për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit për këtë program të plotë studimi është 200 000 (dyqind mijë) lekë, e cila likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit Politeknik të Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1190, datë 13.11.2009

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në vijim AKPT, është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, me seli në Tiranë.

2. AKPT-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen nga titullari. Stema përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr.474, datë 10.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”.

3. Vula zyrtare e AKPT-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e AKPT-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E AKPT-SË

1. AKPT-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. AKPT-ja ka këto përgjegjësi dhe detyra:

2.1. Mbështet bashkërendimin horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare në planifikimin e territorit dhe bashkërendimin vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme, kombëtare e vendore, në fushën e planifikimit të territorit:

a) duke mbledhur autoritetet përgjegjëse të planifikimit e palët e interesuara;

b) duke asistuar në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet tyre dhe duke marrë pjesë në përbërjen e komisionit të ndërmjetësimit, sipas përcaktimeve të shkronjës “c” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”;

c) duke hartuar politika, që lehtësojnë dhe mbështesin bashkëpunimin e bashkërendimin, në çdo nivel, të autoriteteve të planifikimit, për zhvillimin e zbatimin e instrumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit të territorit;

ç) duke ndërmarrë nismën për përcaktimin e rëndësisë kombëtare të një çështjeje në planifikimin e territorit, siguruar botimin e informimin publik, vendosur pezullimin paraprak të zhvillimit, kryer bashkërendimin, këshillimin e pjesëmarrjen e palëve të interesuara dhe propozuar për miratim në KKT (Këshilli Kombëtar i Territorit), sipas dispozitave përkatëse të ligjit për planifikimin e territorit;

d) duke ndihmuar, në bazë të informacionit periodik të marrë, autoritetet kombëtare të planifikimit për procesin e hartimit të instrumenteve të planifikimit dhe duke propozuar përmirësimet e nevojshme të planit të veprimeve e të projektit të instrumentit të planifikimit;

dh) duke shqyrtuar përputhshmërinë e projektit të paraqitur për miratim, me dispozitat ligjore e nënligjore, në fuqi në fushën e planifikimit të territorit dhe instrumentet e planifikimit në fuqi, sipas nenit 38 të ligjit për planifikimin e territorit dhe mbështetur rishqyrtimin e tij në bashkëpunimin dhe autoritetin propozues të planifikimit;

e) duke dhënë mbështetje e orientime, në bazë të informacionit periodik të marrë, për autoritetet vendore të planifikimit për procesin e hartimit të instrumenteve të planifikimit dhe rekomanduar përmirësimet e nevojshme të planit të veprimeve dhe projektit të instrumentit të planifikimit;

ë) duke bashkëvepruar e shkëmbyer të dhëna;

f) duke nxitur dhe asistuar përgatitjen e projekteve të zhvillimit, që kanë efekte në planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

2.2. Këshillon autoritetet e planifikimit për procedurat dhe rregullat e një procesi planifikimi të territorit.

2.3. U ofron njësive të qeverisjes vendore mbështetje për hartimin e politikave dhe të akteve për planifikimin e menaxhimin urban, si dhe kontrollin e zhvillimit.

2.4. Mbështet zhvillimin e cilësive profesionale e teknike të autoriteteve kombëtare e vendore, të planifikimit, nëpërmjet trajnimit dhe ndihmës së drejtpërdrejtë.

2.5. Përgatit e boton manuale metodologjike për planifikimin e territorit, si dhe përgatit e ofron programe trajnimi për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit.

2.6. Kryen studime dhe vlerësime për zhvillimet në territor dhe u ofron informacion e statistika autoriteteve kombëtare e vendore, të planifikimit, palëve të interesuara dhe publikut.

2.7. Përgatit dhe boton, brenda fundit të muajit qershor të çdo viti, bazuar në raportet e autoriteteve të tjera të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit, si dhe në vëzhgimet e kryera prej saj, raportin kombëtar të zhvillimeve në territor të vitit të mëparshëm.

2.8. Sugjeron, në bazë të studimeve e vlerësimeve të kryera e të informacionit që ka, përmirësimin e sistemit ligjor për planifikimin e territorit e të instrumenteve të kontrollit të zhvillimit ose ndërmarrjen e proceseve planifikuese apo të masave të tjera të nevojshme.

2.9. Bashkëpunon me ministrinë e tjera për hartimin e përmirësimit të legjislacionit, duke siguruar instrumentet e duhura institucionale dhe ligjore, për të nxitur financimin e infrastrukturës, kryesisht, në mbështetje të zhvillimit në nivel vendor, përmirësimit të partneritetit publik-privat, politikës së taksës për pasurinë, detyrimeve për shkak të zhvillimit, politikave të taksave për përmirësimin e infrastrukturës dhe mekanizmave të tjerë, që sigurojnë burime për financimin e infrastrukturës.

2.10. Përgatit e propozon aktet nënligjore në zbatim të ligjit për planifikimin e territorit, që lidhen me planifikimin e kontrollit të zhvillimit të territorit dhe me çdo përmirësim të mëtejshëm të tyre e, konkretisht, harton:

a) sipas përcaktimeve të neneve 24 e 62 të ligjit për planifikimin e territorit, rregulloret uniforme të planifikimit të kontrollit të zhvillimit dhe kryen bashkërendimin, këshillimin, dëgjimin publik dhe botimin e tyre në regjistrin e planifikimit të territorit, sipas neneve 36 e 37 të ligjit për planifikimin e territorit;

b) sipas përcaktimeve të nenit 88 të ligjit për planifikimin e territorit, rregulloret model të planifikimit për autoritetet vendore të planifikimit, të cilat nuk kanë miratuar ose nuk përdorin plane territoriale vendore;

c) aktet nënligjore për regjistrin e planifikimit të territorit dhe shpërndan standardet teknike në fuqi të ngritjes dhe administrimit të regjistrit, sipas përcaktimeve të kreut V të ligjit për planifikimin e territorit.

2.11. Kryen funksionet e sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) në organizimin e mbledhjeve dhe përgatit e administron dokumentacionin, që shqyrtohet në to.

2.12. Mbështet autoritetet e planifikimit për mënyrën e regjistrimit dhe të administrimit në mënyrë të pavarur të të dhënave në regjistër dhe këshillon autoritetet e planifikimit për shpërndarjen efektive të tyre të palët e interesuara dhe procedurat e këshillimit.

2.13. Mbështet autoritetet vendore, duke u ofruar asistencë teknike, trajnime dhe infrastrukturë, për botimin e të dhënave në regjistër.

2.14. Informon publikun për proceset e planifikimit dhe siguron aksesin e tij për informacion.

2.15. Mbështet bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e planifikimit të territorit.

2.16. Ushtron përgjegjësi të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj e me akte nënligjore.

KREU III

ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I AKPT-SË

1. AKPT-ja drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Drejtori i Përgjithshëm i AKPT-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit". Zëvendës drejtori i përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. AKPT-ja është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, donacione të huaja dhe burime të tjera të ligjshme. Buxheti i AKPT-së përbën zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,

4. Funksionimi i brendshëm i AKPT-së bëhet sipas rregullores përkatëse, të miratuar nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

KREU IV PROCEDURAT E REKRUTIMIT

1. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AKPT-së rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Drejtori i Përgjithshëm i AKPT-së është eprori direkt, në përputhje me këto dispozita.

2. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të tjerë të AKPT-së rregullohen sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit tjetër në fuqi, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

3. Personeli i AKPT-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara nga drejtori i Përgjithshëm i AKPT-së.

4. Nëpunësit e AKPT-së duhet të kenë arsimin e lartë profesional të nevojshëm në fushën e planifikimit e zhvillimit të përdorimit të tokës, arkitekturës, urbanistikës, planifikimit social, inxhinierisë së ndërtimit, teknologjisë së materialeve, konstruksionit, transportit, gjeologjisë, hidrogeologjisë, mjedisit, ekonomisë, financës, shkencave juridike, të informatikës, inxhinierisë elektronike, teknologjisë së informacionit, gjeomatikës dhe të plotësojnë kërkesat e veçanta, që përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE E TË FUNDIT

1. AKPT-ja kryen të gjitha funksionet, që i janë ngarkuar me ligjin nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

2. Drejtoria e Politikave të Planifikimit Urban dhe Instituti i Studimeve dhe Projektmeve Urbanistike, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, pushojnë së ekzistuari me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe me nisjen e funksionimit të AKPT-së.

3. AKPT-ja harton projektaktet nënligjore brenda afateve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 87 të ligjit për planifikimin e territorit, dhe i paraqet, për shqyrtim e miratim, në Këshillin e Ministrave.

4. AKPT-ja harton dhe vë në zbatim planin e saj të punës për kalimin në sistemin e ri të planifikimit të territorit brenda afateve të përcaktuara nga ligji për planifikimin e territorit, përfshirë hartimin e metodologjive, ofrimin e informimit, trajnimin e këshillimin e nevojshëm.

5. AKPT-ja mbështet dhe ofron këshillimin për autoritetet kombëtare e vendore, të planifikimit, për hartimin, brenda afateve të parashikuara nga ligji për planifikimin e territorit, të planit të përgjithshëm kombëtar, planeve të përgjithshme territoriale vendore dhe planeve të përdorimit të tokës, brenda afateve të parashikuara në nenin 89 të ligjit për planifikimin e territorit.

6. AKPT-ja merr masat e nevojshme për të siguruar një proces të gjerë edukimi dhe ndërgjegjësimi të autoriteteve të planifikimit, palëve të interesuara e publikut, në përgjithësi, gjatë periudhës deri në fillimin e efekteve të plota të ligjit për planifikimin e territorit dhe pas saj, në mënyrë periodike, në përputhje me përcaktimet e nenit 91 të ligjit për planifikimin e territorit, si dhe në bashkëpunim të ngushtë edhe me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, shoqatat e interesuara të biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

8. Deri në rekrutimin e stafit të nevojshëm, shërbimet e buxhetit/financës dhe të prokurimit të kryhen nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
7903

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 21.12.2009
Doli nga shtypi më 22.12.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 48 lekë